



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

K.Sh.Sh.II.nr.640/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha kryetar i kolegjit, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit B.V.S. shpk me seli në Mitrovicë, përfaqësuar nga Drejtori menaxhues B.B., të cilin e përfaqëson me autorizim avokatura Ramaj&Palushi, kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit, në Prishtinë, me bazë juridike, anulim i vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditurës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, K.A.nr.255/22 të datës 09.01.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 25.04.2024, merr:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditues Organi Shqyrtues i Prokurimit në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale - Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, K.A.nr.255/22 të datës 09.01.2021, VËRTETOHET.

A R S Y E T I M

Gjykata Komerciale-Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin e ankimuar, ka vendosur si në vijim: I. Aprovohet si e bazuar kërkesëpapia e paditësit B.V.S. shpk me seli në Mitrovicë, kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit, në Prishtinë, II. Anulohet vendimi PSH.nr.144/19 datës 20.05.2018 i nxjerr nga Paneli Shqyrtues i Prokurimit pranë Organit Shqyrtues i Prokurimit, dhe çështja i kthehet të paditurit në rishqyrtim dhe rivendosje, III Obligohet e paditura që në afat prej 30 ditësh, në riprocedurë të veprj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim, IV Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor e paditura ka ushtruar ankesë, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të; vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të Aprovohet ankesa e të paditurit si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale - Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, K.A.nr.255/22 të datës 09.01.2021 të Anulohet, dhe të mbetet ne fuqi vendimi i OSHP-së, PSH.r.144/19 dt.20.05.2019.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, shqyrtoi ankesën e paditurës, aktgjykimin e ankimuar, si dhe shkresat e tjera të lëndës dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 12 të Ligjit nr.08/L-015, dhe nenit 49 të LKA-së, gjen se;

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se organi i paditur Organi Shqyrtues i Prokurimit në Prishtinë, me vendimin P.SH.nr.144/19 datës 20.05.2019, ka Aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën

e operatorit ekonomik BVS shpk në Mitrovicë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “mirmbajtja, ngritja dhe revitalizimi i sipërfaqeve të gjelbëruara në qytet” me nr.prokurimi 642-18-6460-5-1-1 të inicuar nga Autoriteti Kontraktues – Komuna e Mitrovicës, si dhe ka vërtetuar Njoftimin për anulim të aktivitetit të prokurimit të inicuar nga autoriteti kontraktues Komuna Mitrovicë.

I pakënaqur me vendimin e të paditurës, paditësi me padi inicon konflikt administrativ në Gjykatën e shkallës së parë, e cila në këtë çështje mban seancë të shqyrtimit kryesor me datë 11.12.2023, në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të seancës së shqyrtimit kryesor merr Aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e Aprovon pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit B.V.S. shpk me seli në Mitrovicë, ndërsa ka Anuluar vendimin e të paditues Organi Shqyrtues i Prokurimit P.SH.144/19 dt.20.05.2019, dhe Lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje te e paditura.

Në arsyetim ndër të tjera gjykata e shkallës së parë ka theksuar se vendimi i kundërshtuar është i paqartë dhe kontradiktor me vetveten, nga arsyetimi i vendimit nuk kuptohen arsyet e anulimit të aktivitetit të prokurimit që kanë të bëjnë me tejkalimin e vlerës së parashikuar të aktivitetit të prokurimit. Është e paqartë se vlera totale e ofruar nga paditësi për pozicionin e parë del të jetë 1,054.500€ për peiudhën 12 mujore apo për tre vitet e parashikuara sipas kontratës publike kornizë. Eksperti shqyrtues me raportin e datës 19.04.2019 ka vlerësuar se parashtruesi i ankesës ka ofertuar brenda buxhetit të planifikuar për këtë aktivitet të prokurimit, sipas sasive indikativë të përafërta, të përcaktuara në aneksin 1 të dosjes së tenderit, gjithashtu gjykata vlerosn se raporti i ekspertit shqyrtues V.B., është i paqartë, ngase nuk i ka elaboruar fare pretendimin ankimor të OE, për të konstatuar nëse OE ankues-paditësi ka ofertuar brenda buxhetit të planifikuar për këtë aktivitet të prokurimit.

Dhomat e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes duke shqyrtuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, në bazë të ankesës së paditues dhe sipas detyrës zyrtare të njëjtin e konfirmon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar në prova dhe ligj.

Aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i vlerëson sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së. Kolegji, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar drejtë ligjshmërinë e aktit përfundimtar administrativ në bazë të padisë, përgjigjes në padi provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesorë si dhe shkresave të tjera të lëndës si në vështrim të nenit 44 të LKA, dhe drejtë e ka vendosur çështjen me aprovimin e kërkesë padisë së paditësit.

Dhomat e Shkallës së Dytë vlerëson se vendimi i atakuar i të paditues OSHP-së, përmban të meta të cilat konsistojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të nenit 48 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe në dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik, nuk është vërtetuar drejt gjendja faktike lidhur me pretendimet ankimore gjatë procedimit administrativ nga e paditura, me qka konstatohet se është cënuar ligji në dëm të paditësit me aprovimin e pjesërishtëm të ankesës së tij.

Në raport me pretendimet e paditues në ankesë, se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vlersuar provat e administruara dhe gabimisht aplikoi të drejtën materiale, këto pretendime ankimore, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i refuzoi si të pa bazuara, për faktin se kontradiktat e gjetura nga gjykata e shkallës së parë, e paditura në ankes nuk i konteston fare, por në ankes vetëm bën përshkrimin e aktgjykimit të ankimuar, dhe arsyetimin e tij. E paditura

në ankes nuk spjegon dhe arsyeton shkeljet ligjore për vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të drejtës materiale.

Të metat të cilat i ka konstatuar gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e atakuar, e paditura ka obligim ligjor, ti shqyrtoj në rivendosje, brenda afatit ligjor, në vështrim të nenit 65 të LKA-së. Vërejtjet të cilat i ka konstatuar gjykata e shkallës së parë janë të obligueshme për të paditoren, dhe meqë kemi të bëjmë me anulim të vendimit të atakuar, e njëjta në rivendosje, të shqyrtoj ekzistimin e parregullsive të konstatuara, nga gjykata e shkallës së parë, e të cilat kanë mund të ndikojnë në përmbushjen e kritereve të dosjes së tenderit.

Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se nuk kemi vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, apo aplikim të gabuar të drejtës materiale, dhe se arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejt, i ligjshëm dhe i mbështetur në prova dhe fakte, pasi që gjykata e shkallës së parë e ka arsyetuar vendimin e saj duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Dhomat e Shkallës së Dytë i shqyrtoi edhe pretendimet e tjera të palës ankuese në ankesë mirëpo, të njëjtat ishin të pa bazuara dhe nuk kishin ndonjë ndikim në vendosje ndryshe, andaj edhe vendosi që aktgjykimin e shkallës së parë ta vërteton si të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga të lartë cekurat e në vështrim të nenit 49 të LKA-së, dhe neni 12 të Ligjit 08/L-015, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.Dh.Sh.II.nr.640/2024 me datë 25.04.2024

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari
Krenar Berisha